

Hidromorava KOMPANIA RAJONALE
E UJËSJELLËSIT
HIDROMORAVA Sh.a.
No. 454 Data 28.03.2025
GJILAN



Kompania Rajonale e Ujësjiellësit
"HIDROMORAVA"
Gjilan

RAPORT VJETOR

2024

REPUBLIKË E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA / KOMUNIKACIONI DEPARTAMENTI PËR UJËSJELLËSIT DIREKTORATI PËR UJËSJELLËSIT MINISTRI E TËRRESTRIT MINISTRI E TËRRESTRIT	
Njësia Origj. Jod. Org. Unit.	01/5
Nr. i llogaritjes	60
Nr. i llogaritjes	1776
Nr. i llogaritjes	28.03.25
Nr. i llogaritjes	PRISTINE



kru-hidromorava.com

TABELA E PËRMBAJTJES

1. HYRJE 6

1.1 Vizioni, objektivat dhe strategjitë kyçe	6
--	---

2. BORDI I DREJTORËVE 7

2.1 Mbledhja e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin	7
2.2. Vendimet e Bordit të Drejtorëve	7
2.3. Përbushja e detyrimeve ligjore	9
2.4. Të dhëna për drejtorët jo - ekzekutiv	10
2.5. Numri i takimeve të Bordit dhe pjesëmarrja e drejtorëve në takimet e Bordit	11
2.6. Komisionet e Bordit, përbërja e tyre dhe numri i takimeve të mbajtura	11

3. RAPORTI I KRYESHEFIT EKZEKUTIV 14

3.1. Aktivitetet kryesore të Kryeshefit Ekzekutiv	14
3.2. Aktivitetet e tjera të Kryeshefit Ekzekutiv	14

4. RAPORTI I ZYRES SË SEKRETARES, DEPARTAMENTIT LIGJOR DHE DEPARTAMENTIT PËR BURIME NJERËZORE 15

4.1. Struktura organizative e KRU "Hidromorava" Sh.A.	15
4.2. Përmbledhje e të gjitha procedurave gjyqësore të KRU "Hidromorava" Sh.A.	16

5. RAPORTI I DEPARTAMENTIT FINACIAR 18

5.1. Informacionet lidhur me kapitalin dhe dividendën	18
5.2. Dividenta të paguara gjatë vitit 2024	19
5.3. Një shqyrtim i performancës afariste dhe financiare për vitin 2024	19
5.4. Draft pasqyra e pozitës financiare me datë 31.12.2024	19
5.5. Draft pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse më 31 dhjetor 2024	21
5.6. Draft pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024	21
5.7. Draft pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024	22
5.8. Shenimet shpjeguese të pasqyrave financiare për vitin 2024	23

5.10. Raporti vjetor i performancës operative dhe financiare	33
5.11. Prodhimi i ujit	34
5.12. Faturimi i ujit në m3	34
5.13. Faturimi i ujit në euro (€)	34
5.14. Arkëtimi i ujit në euro (€)	35
5.15. Përqindja e arkëtimit	35
5.16. Shpenzimet operative	36
5.17. Konsumatorë të regjistruar	37
5.18. Konsumatorët aktiv me ujëmatës	37
5.19. Konsumatorët pa ujëmatës	37
5.20. Numri i konsumatorëve aktiv	38
5.21. Faturimi i ujit me ujëmatës	38
5.22. Investimet vetanake	39

6. RAPORTI I ZYRËS SË PROKURIMIT 42

7. RAPORTI I DIVIZIONIT PËR CILËSINË E UJIT 47

7.1. Cilësia e ujit	47
---------------------	----

8. RAPORT PUNES I DEPARTAMENTIT TEKNIK 49

8.1. Divizioni për prodhimin, impiantet, e ujit dhe stacionet e pompimit	49
8.1.1. Furnizimi me ujë	49
8.1.2. Prodhimi, faturimi dhe UPF i ujit në KRU "Hidromorava" – Sh.A.	50
8.1.3. Uji i pafaturuar (UPF)	51
8.2. Divizioni i rrjetit të ujësjellësit	52
8.2.1. Mirëmbajtja e rrjetit të ujësjellësit	52
8.2.2. DMA - zonat	53
8.3. Divizioni i mirëmbajtjes së ujërve të ndotura	54
8.3.1. Mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit	54
8.4. Divizioni për planifikim dhe menaxhim të projekteve	55
8.4.1. Aktivitetet e realizuara gjatë vitit 2024	55

9. PROJEKTET E RËNDËSISHME TË KRU "HIDROMORAVA" GJATË VITIT 2024 56

Lista e tabelave

Tabela 1. Vendimet e Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2024	8
Tabela 2. Përbërja e Bordit të Drejtorëve, pozitat dhe kompensimet nga data: 01.01.2024 deri 31.12.2024	11
Tabela 3. Raport mbi statusin e disa prej projekteve të rëndësishme të menaxhuara nga KRU "Hidromorava" Sh.A.	18
Tabela 4. Investimet vetanake gjatë vitit 2024	19
Tabela 5. Investimet nga donatorët gjatë vitit 2024	24
Tabela 6. Stoqet	25
Tabela 7. Pasuritë tjera afatshkurtra	25
Tabela 8. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë	26
Tabela 9. Zhvlerësimi gjatë vitit 2024	26
Tabela 10. Pasuritë tjera afatshkurtra	27
Tabela 11. Prona, pajisjet dhe impiantet	29
Tabela 12. Treguesit operativ	31
Tabela 13. Treguesit financiarë	31
Tabela 14. Treguesit e performancës	32
Tabela 15. Shpalosje e shpenzimeve 2024/2023	40
Tabela 16. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë vitit 2024 - vlerë minimale	41
Tabela 17. Aktivitetet e zyrës së prokurimit gjatë vitit 2024 - kuotim i çmimit	42
Tabela 18. Aktivitetet e prokurimit gjatë vitit 2024 - procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës	42
Tabela 19. Aktivitetet e prokurimit gjatë vitit 2024 - procedurë e hapur - vlerë e mesme	43
Tabela 20. Aktivitetet e prokurimit gjatë vitit 2024 - procedurë e hapur - vlerë e madhe	43
Tabela 21. Aktivitetet e prokurimit gjatë vitit 2024 - Procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës - Aneks Kontratë	43
Tabela 22. Analizat e cilësisë së ujit gjatë vitit 2024	46
Tabela 23. Vëllimi i ujit në varësi të nivelit të ujit në akumulacion gjatë vitit 2024	48
Tabela 24. Të dhënat e paraqitura për UPF-në, në nivel regjioni për vitin - 2024	49
Tabela 25. Intervenimet në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit	50
Tabela 26. Analiza, prodhimi, faturimi dhe UPF, gjatë vitit 2024 në DMA zonat	52

për regjionin e Gjilanit	53
Tabela 27. Intervenimet në mirëmbajtjen e rrjetit të kanalizimit dhe pastrimit të pusetave	53
Tabela 28. Aktivitetet e realizuara nga DPMP gjatë vitit 2024	55

Lista e shënimeve

Shënim nr. 1 - Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë	23
Shënim nr. 2 - Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat e tjera	24
Shënim nr. 3 - Stoqet	24
Shënim nr. 4 - Pasuritë tjera afatshkurtra	25
Shënim nr. 5 - Prona, pajisjet dhe impiantet	26
Shënim nr. 6 - Investimet në vijim/projektet	26
Shënim nr. 7 - Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera për 2024	27
Shënim nr. 8 - Detyrimet afatshkurtra	28
Shënim nr. 9 - Gjithsej detyrimet afatshkurtra	28
Shënim nr. 10 - Të hyrat e shtyera	28
Shënim nr. 11 dhe 12 - Kapitali aksionar, fitimet e mbajtura, rezervat e kapitalit - Ekuiteti	28
Shënim nr. 13 dhe 14 - Të hyrat dhe grantet	29
Shënim nr. 15 - Shpenzimet e shpërndarjes	29
Shënim nr. 16 - Shpenzimet e zhvlerësimit	29
Shënim nr. 17 - Shpenzimet administrative të tjera	29
Shënim nr. 18 - Fitimi (humbja) para tatimit/fitimi (humbja) e vitit	30
Shënim nr. 19 - Fitimi/humbja e vitit - shpalosje në shënimin nr.20	30
Shënim nr. 20 - Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve - shpalosje në shënimin nr.5	30
Shënim nr. 21 - Rritje/zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme - shpalosje shënimi nr.2	30
Shënim nr. 22 - Rritje/zvogëlim në stoqe - shpalosje shënimi 3	30
Shënim nr. 23 - Rritje/zvogëlim në pasuritë e tjera - shpalosje shënimi nr. 4	31
Shënim nr. 24 - Rritje/zvogëlim në llogaritë e pagueshme tregtare - shpalosje shënimi nr. 8	31
Shënim nr. 25 - Rritje/zvogëlim në detyrimet e tjera - shpalosje në shënimin nr. 9	31

Lista e grafikonëve

Grafikoni 1. Struktura e të punësuarve sipas njësive operative gjatë vitit 2024	15
Grafikoni 2. Struktura e të punësuarve sipas kualifikimit shkollor	16
Grafikoni 3. Prodhimi i ujit	33
Grafikoni 4. Faturimi i ujit m ³	33
Grafikoni 5. Faturimi i ujit në euro (€)	34
Grafikoni 6. Arkëtimi i ujit në euro (€)	34
Grafikoni 7. Përqindja e arkëtimit	34
Grafikoni 8. Shpenzimet operative	35
Grafikoni 9. Konsumator të regjistruar	36
Grafikoni 10. Konsumatorë aktiv me ujëmatës	36
Grafikoni 11. Konsumatorët pa ujëmatës	37
Grafikoni 12. Numri i konsumatorëve aktiv	37
Grafikoni 13. Faturimi i ujit me ujëmatës (m ³)	37
Grafikoni 14. Investimet vetanake	38
Grafikoni 15. Niveli i ujit në akumulacionin e Përlepnicës gjatë vitit 2024	47
Grafikoni 16. Prodhimi i ujit sipas burimeve gjatë vitit 2024	49
Grafikoni 17. UPF gjatë vitit 2024	50

1. HYRJE

1.1 Vizioni, objektivat dhe strategjitë kyçe

Raporti vjetor i punës për vitin 2024 i Kompanisë Rajonale të Ujësjiellësit Hidromorava Sh.A. paraqet një pasqyrë të plotë të aktiviteteve, arritjeve dhe sfidave me të cilat është përballur Ndërmarrja gjatë vitit të kaluar. Ky raport është përgatitur në përputhje me Ligjin mbi Ndërmarrjet Publike, Kodit të Etikës si dhe Udhëzuesit nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike. Përpilimi i tij është realizuar duke u bazuar në praktikën më të mira ndërkombëtare dhe në kërkesat ligjore dhe rregullative në fuqi në Republikën e Kosovës.

Duke marrë parasysh rëndësinë e zbatimit të standardeve ligjore dhe rregullatore, raporti fokusohet në përgjegjësitë dhe detyrimet e ndërmarrjes publike, të cilat janë të përcaktuara qartë brenda kornizës ligjore në fuqi. Bazuar në këtë kornizë, ndërmarrja operon në përputhje me ligjet kryesore që rregullojnë veprimtarinë e saj, përfshirë:

- Ligjin nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare;
- Ligji nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, me Ligjin nr. 05/L-009 si dhe me Ligjin Nr. 08/L-276.

Ky raport shërben si një instrument i rëndësishëm për vlerësimin e performancës së ndërmarrjes, duke identifikuar arritjet, sfidat dhe masat e nevojshme për të përmirësuar shërbimet dhe menaxhimin në përputhje me objektivat strategjike dhe kërkesat ligjore.

Si ofruesi kryesor i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe trajtimit të ujërave të zeza në rajon, kompania është e përkushtuar të sigurojë ujë të pastër dhe cilësor për qytetarët, duke ndjekur standardet më të larta të menaxhimit dhe shërbimit.

Gjatë vitit 2024, KRU Hidromorava ka punuar intensivisht për të përmirësuar infrastrukturën e rrjetit të ujësjiellësit, me qëllim rritjen e efikasitetit operativ dhe adresimin e sfidave të lidhura me menaxhimin e burimeve ujore. Përmes këtij raporti, synohet të ofrohet transparencë mbi aktivitetet e realizuara, duke paraqitur të dhëna të detajuara mbi performancën financiare, investimet, projektet zhvillimore dhe përmirësimet në cilësinë e shërbimeve.

Duke falënderuar Ministrinë e Ekonomisë në cilësinë e Aksionarit, Komunitetin përkatës, të gjithë partnerët, donatorët, punonjësit, konsumatorët si dhe Bordin e Drejtorëve dhe Menaxhmentin për mbështetjen dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm, KRU Hidromorava Sh.A. mbetet e përkushtuar në përmbushjen e misionit të saj për të siguruar furnizim të qëndrueshëm dhe cilësor me ujë për të gjithë qytetarët.

2. BORDI I DREJTORËVE

2.1 Mbledhja e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin

Duke pasur parasysh që Mbledhja e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin është pjesë e mekanizmit zyrtar të qeverisjes korporative gjatë së cilës demonstron llogaridhënia për performancën e Ndërmarrjes dhe rezultatet e vitit të kaluar kalendarik, Bordi i Drejtorëve i KRU "Hidromorava" Sh.A., me datë 14.05.2024, ka mbajtur Mbledhjen e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin në pajtim me nenin 179 paragrafi 1 të Ligjit nr. 06/L-06 mbi Shoqëritë Tregtare. Në këtë mbledhje kanë qenë prezent edhe përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë, konkretisht nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike.

Gjatë Mbledhjes së Përgjithshme me Aksionarin janë shqyrtuar këto pika të rendit të ditës:

- Miratimi i Raportit të Auditorit për Pasqyrat Financiare të Auditimit për vitin 2023
- Miratimi i Raportit Vjetor 2023;
- Performanca e Menaxhmentit të Ndërmarrjes; dhe
- Të ndryshme.

2.2 Vendimet e Bordit të Drejtorëve

Vendimarrja në Bordin e Drejtorëve gjithmonë është bërë në mënyrë të lirë dhe demokratike, duke respektuar të drejtën e lirë dhe pa presion të votimit dhe vendosjes me shumicën e votave të anëtarëve të Bordit.

Duke u bazuar në këtë, Bordi i Drejtorëve gjatë periudhës raportuese ka marrë këto vendime:

Tabela 1. Vendimet e Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2024

Nr.	Vendimi	Nr. vendimit	Data e protokollimit
1.	Vendim për miratimin e Raportit të punës për tremujorin e katërt për vitin 2023" të KRU "Hidromorava" Sh.A, në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve mbajtur me datë: 28.02.2024.	218	29.02.2024
2.	Vendim për miratimin e Raportit Vjetor për vitin 2023 të KRU "Hidromorava" - Sh.A, në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur me datë: 28.02.2024.	258	11.03.2024
3.	Vendim për miratimin e "Raportit për hulumtimin e kënaqshmërisë së konsumatorëve për vitin 2023 të KRU "Hidromorava" Sh.A.", në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur me datë: 26.03.2024.	340	27.03.2024
4.	Vendim për respektimin e Opinioneve nr. 03/574/24 nga AKK - DPKI lidhur me kufizimin e të drejtës së kompensimit si anëtare e Bordit të Drejtorëve të znj. F.T.S.	627	29.05.2024
5.	Vendim për miratimin e "Raportit të Auditimit të Jashtëm për Pasqyrat Financiare për vitin 2023", në mbledhjen e Përgjithshme të Kuvendit të Aksionarit të mbajtur me datë: 14.05.2024.	633	29.05.2024
6.	Vendim për miratimin e "Raportit të punës për tremujorin të parë për vitin 2024 të KRU "Hidromorava" Sh.A", në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur me datë: 29.05.2024	636	29.05.2024
7.	Vendim për miratimin e "Rregullores mbi Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRU "Hidromorava" Sh.A.", në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur me datë: 29.05.2024	649	31.05.2024
8.	Vendim për miratimin e "Rregullores për Përgjegjësinë Disiplinore dhe Materiale të KRU "Hidromorava" Sh.A.", në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur me datë: 29.05.2024	760	28.06.2024
9.	Vendim për miratimin e "Rregullores për Përdorimin e Automjeteve Zyrtare të KRU "Hidromorava" Sh.A.", në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur me datë: 30.07.2024	901	30.07.2024
10.	Vendim për miratimin e "Rishikimit të Planit të Biznesit për vitin 2024", në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më: 30.07.2024.	904	30.07.2024

11.	Vendim për miratimin e "Raportit të punës për tremujorin e dytë për vitin 2024" të KRU "Hidromorava" Sh.A", në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më: 27.08.2024.	1020	27.08.2024
12.	Vendimi për njohjen e të drejtës në kompensim të shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të ndërlidhura me të për mbajtjen e takimeve të Bordit të Drejtorëve në KRU "Hidromorava" Sh.A. për anëtarin e Bordit të Drejtorëve z. Arban Hoxha.	1090	12.09.2024
13.	Vendim për respektimin e Opinionit nr. 03/574/24 nga AKK – DPKI lidhur me kufizimin e të drejtës së kompensimit si anëtar i Bordit të Drejtorëve të z. A.H.	1091	12.09.2024
14.	Vendim për miratimin e "Planit të Biznesit për vitin 2025 – 2027 të KRU "Hidromorava" Sh.A." në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më: 28.10.2024.	1561	30.10.2024
15.	Vendim për miratimin e "Raportit të punës për tremujorin e tretë për vitin 2024" të KRU "Hidromorava Sh.A.", në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më: 22.11.2024.	1651	22.11.2024
16.	Vendim për shfuqizimin e Vendimit nr. 627 të dt. 29.05.2024 sa i përket kufizimit të së drejtës së kompensimit me pagesë të anëtares së Bordit të Drejtorëve, znj. F.T.S.	1683	29.11.2024

2.3. Përbushja e detyrimeve ligjore

Me qëllim të përbushjes së objektivave dhe politikave zhvillimore të vendosura nga Aksionari për të drejtuar Ndërmarrjen drejt suksesit, Bordi i Drejtorëve ka vepruar në mënyrë efikase dhe kolegjiale, si një ekip, brenda kornizës ligjore dhe rregullative. Gjatë vitit 2024, Bordi ka përbushur me përgjegjësi të gjitha detyrimet ligjore për raportime të rregullta, të cilat rrjedhin nga Ligji për Ndërmarrjet Publike.

Raporti vjetor për vitin 2023 u i miratuar nga Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur më 28.02.2024, përbush kërkesat ligjore në përputhje me nenin 31 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike. Ky raport ofron një pasqyrë të plotë të aktiviteteve dhe performancës së Ndërmarrjes gjatë vitit të kaluar duke përfshirë edhe arritjet operationale të secilës njësi operative. Raporti ofron një vlerësim të ekuilibruar dhe të qartë të performancës së ndërmarrjes dhe përshkruan perspektivat për të ardhmen.

Auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2023, është kryer nga Kompania e Licencuar "H&N" Sh.P.K. Prishtinë, konform ligjeve aktuale në fuqi. Auditimi ka përfunduar sipas afatit të përcaktuar ligjor dhe duke u bazuar në këtë Bordi i Drejtorëve në Mbledhjen e Përgjithshme të Kuvendit të Aksionarit të mbajtur më 14.05.2024, ka miratuar Raportin e Auditorit të Pavarur dhe Pasqyrat Financiare për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2023,

në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Raporti i Auditorit të Pavarur për KRU "Hidromorava" Sh.A. Gjilan për vitin 2023, jep Opinion të Kualifikuar lidhur me Auditimin e Pasqyrave Financiare.

Baza për opinionin e dhënë nga auditorët është përshkruar në paragrafin "Opinion i kualifikuar", ku thuhet se pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale (ose japin një pamje të vërtetë dhe të drejtë) për pozicionin financiar të Ndërmarrjes më 31 dhjetor 2023, rezultatin financiar dhe rrjedhjen e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit financiar (SNRF).

Bordi i Drejtorëve ka miratuar "Rishikimit të Planit të Biznesit për vitin 2024", në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më: 30.07.2024. dhe "Planin e Biznesit 2025 - 2027" (me plotësim ndryshime) në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të mbajtur më: 28.10.2024, konform nenit 17 të Ligjit 04/L-111 për ndryshim dhe plotësimin e Ligjit Bazik nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike.

Shënim: Raporti Vjetor dhe raportet tre mujore në formë të njoftimit i janë dërguar edhe Kryetarëve të Komunave të Gjilanit, të Kamenicës dhe të Vitisë, pasi që Ndërmarrja jonë ushtron veprimtarinë e saj në këto komuna dhe e tërë kjo konform nenit 31 paragrafi 6 të Ligjit Nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, me ndryshim plotësim nga Ligji Nr.04/L-111, si dhe me ndryshim plotësim nga Ligji Nr.05/L-009.

2.4. Të dhëna për drejtorët jo - ekzekutiv

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin 05/L-009, si dhe të nenit 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryemnisitrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me Nenin 19 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë: 09.03.2022 pas një procedure të hapur, transparente dhe konkurruese, ekskluzivisht në bazë të meritave, për KRU "Hidromorava" Sh.A. Gjilan më datë 09.03.2022 merr vendimin nr. 09/67 për emërimin e Bordit të Drejtorëve me këtë përbërje:

- Z. Habil Zeqiri- Kryesues i Bordit të Drejtorëve;
- Znj. Filloretë Gashi Sadiku – anëtare e Bordit të Drejtorëve;
- Znj. Ferdane Tahiri Sylejmani – anëtare e Bordit të Drejtorëve;
- Z. Arban Hoxha – anëtar i Bordit të Drejtorëve;
- Znj. Lindita Fazli – anëtare e Bordit të Drejtorëve, dhe
- Z. Agim Zeka – anëtar i Bordit të Drejtorëve.

Ndërsa, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

të nenit 15 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-111 dhe me Ligjin 05/L-009, si dhe të nenit 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryemnisitrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021, në pajtim me Nenin 19 të Rregullores së Punës të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë: 16.11.2023, merr vendimin 03/173 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë nr. 09/67 të datës: 09.03.2022 për emërimin e Bordit të Drejtorëve si në vijim:

- Znj. Filloretë Gashi Sadiku – Kryesuese e Bordit të Drejtorëve dhe
- Z. Habil Zeqiri - anëtar i Bordit të Drejtorëve.

Tabela 2. Përbërja e Bordit të Drejtorëve, pozitat dhe kompensimet nga data: 01.01.2024 deri 31.12.2024

Nr.	Emri e Mbiemri	Pozita	Kompensimi		
			BD	KA	
1.	Filloretë Gashi Sadiku	Kryesuese e Bordit të Drejtorëve	450 €	-	-
2.	Ferdane Tahiri Sylejmani	Kryesuese e Komisionit të Auditimit	320 €	110€	430€
3.	Lindita Fazliu	Anetare e Bordit të Drejtorëve	320 €	80 €	400 €
4.	Habil Zeqiri	Anetar i Bordit të Drejtorëve	320 €		
5.	Agim Zeka	Anëtar i Bordit të Drejtorëve	320 €		
6.	Arban Hoxha	Anëtar i Bordit të Drejtorëve	320 €		

Në KRU "Hidromorava" SH.A. kompensimet për drejtorët, që nga fillimi i emërimit të Bordit të Drejtorëve e deri me rastin e raportimit, janë bërë konform Vendimit Nr. 07/81 të datës: 23.03.2016.2010 - mbi lartësinë e kompensimit të anëtarëve të bordeve të ndërmarrjeve publike qendrore sipas kategorizimit të vendosur nga Aksionari – Qeveria e Kosovës.

2.5. Numri i takimeve të Bordit gjatë vitit dhe pjesëmarrja e drejtorëve në takimet e Bordit

Gjatë vitit 2024, me qëllim të përmbushjes së misionit dhe kryerjes së detyrave të tyre në mënyrë sa më efikase, Bordi i Drejtorëve ka mbajtur njëmbëdhjetë (11) mbledhje të rregullta. Pjesëmarrja e drejtorëve ka qenë pothuajse e plotë gjatë gjithë këtyre takimeve, pra gjatë këtyre takimeve të Bordit të Drejtorëve gjithmonë ka pasur kourum të nevojshëm për vendimarrje.

2.6. Komisionet e Bordit, përbërja e tyre dhe numri i takimeve të mbajtura

Ministria e Ekonomisë, me Vendimin nr. 563 të datës: 17.03.2022, e cakton Komisionin e Auditimit në kuadër të Bordit të Drejtorëve në përbërje prej:

- Znj. Ferdane Tahiri Sylejmani – Kryesuese e Komisionit të Auditimit;
- Znj. Lindita Fazliu – anëtare e Komisionit të Auditimit;
- Znj. Filloretë Gashi Sadiku – anëtare e Komisionit.

Pasi sipas Ligjit të Ndërmarrjeve Publike, Kryesuesi i Bordit nuk lejohet të jetë pjesë e Komisionit të Auditimit, pas Vendimit Nr. 03/173 për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 09/67 të datës 9 mars 2022 për emërimin e Bordit të Drejtorëve të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidromorava" Sh.A., Gjilan, znj. Filloretë Gashi Sadiku që nga data: 16 nëntor 2023 me automatizëm konsiderohet që nuk është më pjesë e Komisionit të Auditimit.

Komisioni i Auditimit gjatë vitit 2024 ka mbajtur dhjetë (10) mbledhje të rregullta dhe tri (3) mbledhje të jashtëzakonshme, gjatë të cilave janë shqyrtuar çështjet thelbësore të afarizmit të Ndërmarrjes para shqyrtimit dhe miratimit të tyre në Bord të Drejtorëve.

Komisioni i Auditimit ka realizuar një punë të vazhdueshme dhe shumë të rëndësishme gjatë vitit të kaluar, duke kontribuar në forcimin e transparencës dhe efikasitetit të menaxhimit të burimeve dhe procesëve financiare.

Përveç shqyrtimit të Raporteve të Auditimit, Komisioni ka shqyrtuar gjithashtu Raportin njëvjeçar të punës për vitin 2023, i cili ofron një pasqyrë të detajuar të aktiviteteve dhe rezultateve të arritura gjatë vitit, si dhe ka shqyrtuar Raportet tremujore operative dhe financiare. Këto raporte kanë ofruar informacion të vlefshëm për monitorimin e performancës dhe për përcaktimin e mundësive për përmirësimin e menaxhimit të brendshëm dhe alokimit të burimeve financiare.

Një element i rëndësishëm i punës së Komisionit ka qenë ofrimi i rekomandimeve për menaxhmentin e KRU "Hidromorava" SH.A., si dhe për Zyrën e Prokurimit, për të siguruar që proceset dhe procedurat të jenë të drejta, transparente dhe të përputhshme me ligjet dhe politikat në fuqi. Rekomandimet e Komisionit kanë ndihmuar në rritjen e efikasitetit dhe profesionalizmit të operacioneve të kompanisë, si dhe në përmirësimin e proceseve të kontrollit dhe menaxhimit të riskut.

Komisioni i Auditimit, gjatë vitit 2024, unanimisht ka miratuar Raportet e Auditimit si në vijim:

1. Raporti Final i Auditimit mbi Ligjshmërinë e Realizimit të Projektit – "Ndërtimi i Rrjetit të Ujësjellësit në fshatin Karaçevë e Epërme në Komunën e Kamenicës" – Situacioni i parë i përkohshëm;

2. (Aneks) Raporti Final i Auditimit mbi Ligjshmërinë e Realizimit të Projektit – "Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Karaçevë e Epërme në Komunën e Kamenicës" – Situacioni i dytë i përkohshëm;

3. Raporti i Auditimit mbi ligjshmërinë e projektit "Kycjet Individuale për fshatrat

Muçivërcë, Dajkoc, Hodonoc, Novosellë, Shipashnicë e Ulët, Roganë - Komuna e Kamenicës",
- Pagesa e avansit";

4. Raporti mbi Ligjshmërinë e Projektit Kapital "Kycjet Individuale për Fshatrat Hodonoc dhe Dajkoc në Komunën e Kamenicës - Situacioni i III-të dhe përfundimtar";

5. Raporti i Auditimit "Kycjet individuale për fshatrat Muçivërcë, Dajkoc, Hodonoc, Novosellë, Shipashnicë e Ulët, Roganë - Komuna e Kamenicës - Situata e parë e përkohëshme e punëve të kryera";

6. Plotësim/ndryshimi i Raportit për procedurat e prokurimit "Kycjet Individuale për fshatrat Muçivërcë, Dajkoc, Hodonoc, Novosellë, Shipashnicë e Ulët, Roganë - Komuna e Kamenicës"

7. Raporti i Auditimit mbi ligjshmërinë e realizimit të projektit "Rehabilitimi i shtatë puseve - pusetës kryesore dhe impiantit në Velekincë";

8. Raporti i Auditimit mbi ligjshmërinë e realizimit të projektit - Kycjet individuale për fshatrat Muçivërcë, Dajkoc, Hodonoc, Novosellë, Shipashnicë e Ulët, Roganë - Komuna e Kamenicës - Situata e dytë e përkohëshme e punëve të kryera";

9. Raporti i Auditimit mbi ligjshmërinë e realizimit të projektit - "Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Cërnice" - Komuna e Gjilanit - Situata e I-rë (parë) e përkohëshme e punëve të kryera";

10. Raporti i Auditimit mbi ligjshmërinë e realizimit të projektit - "Rehabilitimi i 7 puseve, pusetës kryesore dhe impiantit në Velekincë - punët shtesë" në Komunën e Gjilanit;

11. Raporti i Auditimit mbi ligjshmërinë e realizimit të projektit - "Ndërtimi i rrjetit të ri të ujësjellësit dhe kalimi i kyçjeve individuale të konsumatorëve nga gypat AC dhe HDPE në qytetin e Vitisë";

12. Aneks Raporti i Auditimit mbi ligjshmërinë e realizimit të projektit - "Rehabilitimi i 7 puseve, pusetës kryesore dhe impiantit në Velekincë, në Komunën e Gjilanit - Situata e dytë përfundimtare e përkohëshme e punëve të kryera";

13. Aneks Raporti i Auditimit mbi ligjshmërinë e realizimit të projektit - "Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Karaçevë e Epërme në Komunën e Kamenicës, Situacioni i tretë i përkohshëm i punëve të kryera";

14. Aneks Raporti i Auditimit mbi ligjshmërinë e realizimit të projektit - "Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Cërnice, Komuna e Gjilanit - Situata e dytë e përkohëshme e punëve të kryera";

15. Raporti i Auditimit mbi ligjshmërinë e realizimit të projektit - "Furnizimi me ujëmatës, bllomba dhe bllokues".

Bordi i Drejtorëve të KRU "Hidromorava" Sh.A., edhe gjatë vitit 2024 nuk e ka vlerësuar si të nevojshme themelimin e komisioneve të tjera, qoftë të përkohëshme apo të përhershme.

3. RAPORTI I KRYESHEFIT EKZEKUTIV

3.1. Aktivitetet kryesore të Kryeshefit Ekzekutiv

Raporti i përket periudhës raportuese të vitit 2024 dhe ndërlidhet me performancën aktuale financiare dhe operative, përshkrimin e arritjeve të caqeve të planit të biznesit të Kompanisë Rajonale të Ujësjiellësit "Hidromorava" – Sh.A. Gjilan.

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, Kryeshefi Ekzekutiv është fokusuar që t'i tejkalojë sfidat kryesore për Ndërmarrjen të cilat kanë qenë dhe mbeten:

- furnizimi i rregullt i konsumatorëve me ujë të sigurtë gjatë 24 orëve në ditë;
- rritja e faturimit dhe arkëtimit;
- zvogëlimi i ujit të pafaturuar;
- identifikimi i lidhjeve ilegale;
- zvogëlimi i numrit të konsumatorëve pa ujëmatës;
- eliminimi i pagesave me kesh etj.

Është siguruar një mbikëqyrje më e madhe në të gjithë sektorët punues konform aktiviteteve të ushtruara si: në leximin e rregullt të ujëmatësve, efikasitetin e shtuar në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjiellësit, sigurimin dhe montimin e ujëmatësve për konsumatorët me paushall etj.

3.2. Aktivitetet e tjera të Kryeshefit Ekzekutiv

Kryeshefi Ekzekutiv i KRU "Hidromorava" mban takime të rregullta me institucione lokale dhe ndërkombëtare, donatorë dhe operatorë ekonomikë, me qëllim rritjen e efikasitetit të Ndërmarrjes. Gjatë një serie takimesh gjatë vitit 2024, janë diskutuar çështje të rëndësishme për përmirësimin e shërbimeve të ujit dhe kanalizimit, si dhe zhvillimin e strategjive menaxhuese të Ndërmarrjes. Takimet përfshijnë bashkëpunime me Komunën e Gjilanit, Komunën e Kamenicës dhe organizata ndërkombëtare si EBRD, OSBE dhe Banka Botërore, ku është diskutuar për projekte infrastrukturore dhe mundësi financimi. Fokusi kryesor ka qenë përgatitja e projekteve për vitet 2025-2026, përmirësimi i menaxhimit të ujësjiellësve dhe impianteve të ujërave të zeza, si dhe bashkëpunimi për realizimin e projekteve të përbashkëta. Takimet gjithashtu kanë përfshirë vizita edukative dhe trajnime ndërkombëtare për forcimin e kapaciteteve në menaxhimin e infrastrukturës.

4. RAPORTI I ZYRËS SË SEKRETARES, DEPARTAMENTIT LIGJOR DHE DEPARTAMENTIT PËR BURIME NJERËZORE

4.1. Struktura organizative e KRU "Hidromorava" Sh.A.

Një prej faktorëve që esencialisht ndikon në performancën dhe zhvillimin efikas të Ndërmarrjes është potenciali njerëzor, i cili është resursi më meritues në menaxhimin e veprimtarisë me plotë përgjegjësi në përmbushjen e qëllimit në drejtim të funksionimit të Ndërmarrjes.


Gjatë periudhës raportuese për vitin 2024, numri i të punësuarve në KRU "Hidromorava Sh.A. ka variuar si në vijim:

- Dhjetë (10) persona janë punësuar sipas konkursit të rregullt publik;
- Shtatë (7) të punësuar janë risistemuar sipas konkursit të brendshëm;
- Katër (4) të punësuarve u është ndërprerë kontrata e punës sipas fuqisë ligjore – (pensionimit).

Gjatë vitit 2024 KRU "Hidromorava" Sh.A, ka operuar me 165 të punësuar të shpërndarë si në vijim:


- në Njësinë Operative Gjilan 128 të punësuar;
- në Njësinë Operative në Viti 20 të punësuar; dhe
- në Njësinë Operative në Kamenicë 17 të punësuar.

Të tri Njësitë Operative kanë shërbimin administrativ, financiar dhe teknik.



Grafikoni 1. Struktura e të punësuarve sipas njësive operative gjatë vitit 2024

Grafikoni 1: Nga numri i përgjithshëm i të punësuarve gjatë vitit 2024, 128 ose 77.57% e të punësuarve janë në Njësine Operative në Gjilan, 20 ose 12.12% e të punësuarve në Njësine Operative në Viti dhe 17 ose 10.3 % e të punësuarve janë në Njësine Operative në Kamenicë.



Grafikoni 2. Struktura e të punësuarve sipas kualifikimit shkollor

Grafikoni 2: Nga numri i tërësishëm i të punësuarve gjatë vitit 2024, 7 ose 4,24% e të punësuarve kanë përgatitje të lartë superiore, 30 ose 18.18% kanë përgatitje të nivelit bachelor dhe shkollë të lartë, 111 ose 67.27% e të punësuarve kanë përgatitje të mesme shkollë, 18 ose 10.9% e të punësuarve kanë përgatitje të ulët shkollë.

4.2. Përmbledhje e procedurave gjyqësore të KRU "Hidromorava" Sh.A.

Gjatë vitit 2024, KRU "Hidromorava" Sh.A. ka qenë në proces të disa kontesteve juridike pranë gjykatave kompetente. Këto çështje kanë përfshirë aspekte të ndryshme ligjore që lidhen me funksionimin dhe aktivitetet e kompanisë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në, detyrimet kontraktuale, shqyrtimin e ankesave dhe padive të ndryshme, si dhe çështje të tilla si "pritjet e vendimeve për rrogat jubilarë dhe borxhet ndaj kreditorëve", "dënime për vepra penale si 'vjedhje e rëndë në tentativë' dhe 'vjedhje e shërbimeve'", "refuzime të ankesave për ndryshimin e vendimeve të mëparshme" dhe "rishikime dhe rivendosje të çështjeve të cilat kthehen në gjykata për shqyrtimin e mëtejshëm".

Të gjitha proceset janë zhvilluar në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim sigurimin e zbatimit të drejtësisë dhe mbrojtjen e interesave të KRU Hidromorava.

Numri total i lëndëve të shqyrtuara ka arritur në 44 raste, të cilat janë ndarë si më poshtë:

- Gjykata e Apelit e Kosovës – Prishtinë: 9 raste
- Gjykata Themelore në Gjilan – Departamenti i Përgjithshëm: 26 raste
- Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhoma e Shkallës së Dytë: 2 raste

- Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës: 2 raste
- Gjykata Themelore në Gjiilan – Dega në Kamenicë: 4 raste
- Gjykata Themelore në Gjiilan – Dega në Viti: 1 rast

Nga gjithsej 44 lëndë të shqyrtuara, 38 raste janë përfunduar në favor të KRU 'Hidromorava' Sh.A., duke reflektuar një rezultat pozitiv dhe mbrojtjen e interesave të Ndërmarrjes gjatë këtyre proceseve ligjore. Sa i përket gjashtë lëndëve të tjera, ato janë aprovuar ato pjesërisht nga Gjykatat kompetente, duke i konsideruar të bazuara kryesisht në lidhje me parashkrimin e borxheve, për të cilat raste, brenda afatit ligjor kemi parashtruar ankesa në Gjykatën e Apelit.



5. RAPORTI I DEPARTAMENTIT FINACIAR

5.1. Informacionet lidhur me kapitalin dhe dividendën

Në draft pasqyrat financiare shihet se për shkak të rritjes së efikasitetit operativ, pas provizionimit të borxheve të këqija, Ndërmarrja ka rezultat financiar me fitim prej 52,254.00 €.

- Ndërmarrja nuk ka kredi të rëndësishme të nënshkruara apo paguara gjatë vitit 2024;
- Investime vetanake gjatë vitit 2024 ka pasur në vlerë prej: 482,529.43€;
- Investimet nga donatorët gjatë vitit 2024 kanë qenë në vlerë prej: 1,546,625.00€.

Nr.	Investime vetanake gjatë vitit 2024	Vlera në €
1.	Objektet ndërtimore - administratë	30,182.94
2.	Rehabilitim i rrjetit të ujësjellësit	38,985.50
3.	Pajisje elektrike - mekanike	27,656.83
4.	Ujëmatës	37,593.12
5.	Makineri e rëndë	47,624.24
6.	Automjete transporti	136,940.68
7.	Pajisje laboratorike	10,757.20
8.	Programi Arc GIS	23,686.44
9.	Pajisje për teknologji informative	14,642.11
10.	Pajisje për zyre	5,706.83
11.	Shtimi i kapacitetit të ujit përmes restaurimit të rezervuarit dhe poshit në Berivojcë	44,784.54
12.	Ndërtimi i garazhës dhe depos	26,325.00
13.	Ndërrimi i gypave në zonën e shërbimit	37,644.00
	Githsej:	482,529.43

Nr.	Investimet në vijim nga donatorët/Ministria e Ekonomisë	Vlera në €
1.	Investime në kycje individuale - Rrjeti i ujësjellësit në Komunën e Kamenicës	356,218.02
2.	Investime në rehabilitimin e FPU në Velekincë	148,105.77

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2024

3.	Investime në vijim - Impianti për trajtimin e ujërave të zeza në Gjilan - ITUZ	303,712.00
4.	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit Karaçevë të Epërme	222,870.53
5.	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kalimi i kycjeve individuale nga gypat AC në HDPE	91,032.70
6.	Shtimi i kapacitetit të ujit përmes restaurimit të rezervuarit dhe pusit në Berivojcë	37,765.00
7.	Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në Cërnice	386,921.21
	Gjithsej:	1,546,625.00

Tabela 3. Investimet vetanake gjatë vitit 2024

Tabela 4. Investimet nga donatorët gjatë vitit 2024

5.2. Dividenda të paguara gjatë vitit 2024

Gjatë periudhës së raportimit nuk është paguar dividendë.

5.3. Një shqyrtim i performancës afariste dhe financiare për vitin 2024

- Paratë në arkë: 1,007,870.00€;
- Fitimi/humbja: 52,254.00 €;
- Ekuiteti aksionar, rezervat dhe detyrimet: 45,821,536.00 €;
- Zhvlerësimi i aseteve është bërë sipas kategorive të përcaktuara me SNK.

5.4. Draft pasqyra e pozitës financiare me datë 31.12.2024

	Shënimi	2024 €	2023 €
PASURITË			
Pasuritë afatshkurtra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	1	1,007,870.00	904,953.00
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	2	3,165,769.00	3,579,021.00
Stoqet	3	462,659.00	409,344.00
Pasuritë e tjera afatshkurtra	4	110,875.00	103,578.00
Gjithsej pasuritë afatshkurtra		4,747,173.00	4,996,896.00
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	5	46,015,495.00 ¹	7,331,981.00

¹ Dallimi në vlerën e aseteve krahasuar me vitin e kaluar vjen si rezultat i rivlerësimit të kryer gjatë këtij viti. Në pasqyrat financiare të vitit 2024 është reflektuar vlera reale e aseteve, bazuar në rivlerësimin e kryer nga kompania e licencuar NEXIA KOSOVO AUDIT LLC. Ky proces ka mundësuar një prezantim më të saktë dhe në përputhje me standardet kontabël të vlerës së aseteve të ndërmarrjes

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT "HIDROMORAVA" GJILAN

Prona investuse			
Investimet në vijim	6	2,085,505.00 ²	1,687,275.00
Pasuritë e paprekshme			
Pasuritë e shtyra tatimore			
Pasuritë e tjera afatgjata			
Gjithsej pasuritë afatgjata		48,101,000.00	9,019,256.00
Gjithsej pasuritë		52,848,173.00	14,016,152.00

DETYRIMET DHE EKUITETI

DETYRIMET

Detyrimet afatshkurtra			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	7	104,143.00	139,478.00
Kreditë dhe huatë, pjesa afatshkurtes			-
Tatimet e pagueshme aktuale			-
Të hyrat e shtyera		-	-
Provizionet afatshkurtra			
Detyrimet e tjera afatshkurtra	8	147,143.00	145,887.00
Gjithsej detyrimet afatshkurtra	9	251,819.00	285,965.00
Detyrimet afatgjata			
Kreditë dhe huatë, pjesa afatgjate			-
Provizionet afatgjate			-
Detyrimet ndaj lizingut pjesa afatgjate			
Detyrimet nga grantet	10	6,774,818.00 ³	6,043,940.00
Detyrimet e tjera afatgjate		-	-
Gjithsej detyrimet afatgjate		6,774,818.00	6,043,940.00
Gjithsej detyrimet		7,026,637.00	6,329,305.00

EKUITETI

Kapitali aksionar	11	25,000.00	25,000.00
Fitimet/humbjet e bartura		-335,418.00	(387,672.00)
Rezervat e tjera		8,049,519.00	8,049,519.00
Rezervat e rivlerësuar	12	38,082,435.00	
Gjithsej ekuiteti		45,821,536.00	7,686,847.00
Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet		52,848,173.00	14,016,152.00

² Vlera e re e asetëve reflekton edhe në Investimet në vijim.

³ Vlera e re e asetëve të rivlerësuar reflekton edhe të zëri i të hyrave të shtyera.

5.5. Draft pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse më 31 dhjetor 2024

Të hyrat	13	2,467,351.00	2,376,364.00
Të hyrat e tjera		46,789.00	47,645.00
Të ardhurat tjera financiare	14	477,941.00	435,117.00
Total të hyrat		2,992,081.00	2,859,126.00
Shpenzimet e shpërndarjes (personelit)	15	-1,504,219.00	(1,426,625.00)
Shpenzimet administrative (zhvlerësimet)	16	-751,791.00	(666,573.00)
Shpenzimet e tjera operative	17	-676,975.00	(692,404.00)
Shpenzimet e provizionit		-2,932,985.00	(2,785,602.00)
Total shpenzimet		-	-
Fitimi/(humbja) operative	18	59,096.00	73,524.00
Shpenzimet financiare		-	-
Shpenzimet e tatimit në fitim		-6,842.00	(7,352.00)
Fitimi/(humbja)/i/ e periudhës	19	52,254.00	66,172.00
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave financiare të operacioneve të huaja, neto nga tatimi		-	-
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të periudhës		-	-
Gjithësej të ardhurat/(humbjet) gjithëpërfshirëse të periudhës		-	-

5.6. Draft pasqyra e ndryshimeve në ekuitet për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024

	Kapitali aksionar €	Fitimet e mbajtura €	Rezervat e rivlerësuar €	Rezervat e tjera €	Gjithsej €
Gjendja më 01 janar 2022	25,000.00	-602,207.00		8,049,519.00	7,472,312.00
Fitimi/(Humbja) i/e vitit	-	148,363.00		-	148,363.00
Dividentat	-	-		-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-		-	-
Ndarje e rezervave	-	-		-	-

KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT "HIDROMORAVA" GJILAN

Gjendja më 31 dhjetor 2022	25,000.00	-453,844.00		8,049,519.00	7,620,675.00
Gjendja më 01 janar 2023	25,000.00	-453,844.00		8,049,519.00	7,620,675.00
Fitimi humbja i/e vitit	-	66,172.00		-	66,172.00
Dividentat	-	-		-	-
Deponimet e kapitalit shtesë	-	-		-	-
Ndarje e rezervave	-	-		-	-
Gjendja më 31 dhjetor 2023	25,000.00	-387,672.00		8,049,519.00	7,686,847.00
Gjendja më 01 Janar 2024	25,000.00	-387,672.00	38,082.435.00*	8,049,519.00	45,769,282.00
Fitimi humbja i/e vitit		52,254.00			52,254.00
Dividentat					
Deponimet e kapitalit shtesë					
Ndarje e rezervave					
Gjendja më 31 dhjetor 2024	8,049,519.00	-335,418.00	38,082.435.00	8,049,519.00	45,821,536.00

* Rezervat e rivlerësuar pasqyrojnë ndryshimin në vlerën e aseteve si rezultat i rivlerësimit të kryer në vitin 2024 nga kompania e licencuar NEXIA KOSOVO AUDIT LLC. Ky rivlerësim ka sjellë një dallim nga viti i kaluar, duke reflektuar vlerën e re të aseteve sipas vlerësimit të tregut.

5.7. Draft pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024

	Shënimi	2024 €	2023 €
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi/(Humbja) i/e periudhës		52,254.00	66,172.00
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave		-	-
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	20	751,791.00	666,573.00
Dëmtimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve		-	-
Amortizimi i pasurive të paprekshme		-	-
Ndryshimi i vlerës së pronës investuese		38,082,435.00*	-
Të ardhurat financiare		-	-
Shpenzimet financiare		-	-
(Fitimi)/humbja nga shitja e pronës, fabrikës dhe pajisjeve		-	-
Shpenzimet e tatimit në fitim		-	-
		38,886,480.00	732,745.00
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
(Rritja)/zvogëlimi në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	21	413,252.00	204,394.00
(Rritja)/zvogëlimi në stoke	22	(53,315.00)	(131,753.00)
(Rritja)/zvogëlimi në pasuritë e tjera	23	-7,297.00	(42,907.00)
Rritja/(zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	24	-35,335.00	22,583.00

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2024

Rritja/(zvogëlimi) në detyrimet e tjera	25	1,789.00	42,821.00
Rritja/(zvogëlimi) në detyrimet e tjera nga grantet		730,878.00	1,249,165.00

Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		-39,833,535.00	-1,862,873.00
--	--	-----------------------	----------------------

Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve		-39,833,535.00	(738,867.00)
Arkëtimet për shitjen e pronës, pajisjeve dhe impianteve		(880,149.00)	1,124,006.00
Pagesat për blerjet e pasurive të paprekshme		-	-
Arkëtimet për shitjen e pasurive të paprekshme		-	-
Interesi i arkëtuar		-	-
Dividentat e paguara		-	-

Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		(1,751,099.00)	(1,862,873.00)
---	--	-----------------------	-----------------------

Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Deponimet e kapitalit shtesë		-	-
Dividentat e paguara		-	-
Arkëtimet nga kreditë dhe huatë		-	-
Ripagimi i kredive dhe huave		-	-
Pagesat e lizingut financiar		-	-

Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		-	-
---	--	----------	----------

Rritje/(zvogëlim) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë		102,917.00	214,175.00
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të periudhës		904,953.00	690,778.00

Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të periudhës		1,007,870.00	904,953.00
--	--	---------------------	-------------------

* Ndryshimi në pronën investuese pasqyron investimet dhe rregullimet e bëra gjatë vitit 2024, të cilat kanë ndikuar në rrjedhjen e parasë. Ky ndryshim përfshin Rivlerësimin e pronës investuese, i cili nuk ka ndikuar drejtpërdrejt në rrjedhjen e parasë, por është pasqyruar në ekuitet përmes rezervave të rivlerësimit.

5.8. Draft pasqyra e rrjedhjes së parasë për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2024⁴

Shënim nr. 1 - Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë

Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë paraqesin tepricat (salldot) përfundimtare të parasë së deponuar në bankat komerciale dhe në arkë me 31 dhjetor 2024 dhe atë si në vijim:

⁴ Pasqyrat financiare për vitin 2024 është përgatitur në përputhje me Standardet e Kontabilitetit Financiar. Në këto pasqyra financiare është përfshirë edhe vlera e re e rivlerësuar e aseteve, e përcaktuar nga kompania e licencuar NEXIA KOSOVO AUDIT LLC.

Tabela 5. Paraja e gatshme dhe ekuivalentët e parasë

Paraja në arkë dhe në bankë është si vijon:

Përshkrimi	31.12.2024 Vlera në €	31.12.2023 Vlera në €
Arka kryesore	-	-
Arka e shpenzimeve (Para të imta)	335.98	850.77
Banka	1,007,534.25	904,102.00
Gjithsej arka	1,007,870.23	904,952.77

Shënim nr. 2 - Llogaritë e arkëtueshme dhe kërkesat e tjera

	31.12.2024 Vlera në €	31.12.2023 Vlera në €
Llogaritë e arkëtueshme	7,747,379.00	8,165,575.00
Provizioni i llogarive për amvisëri	(3,629,682.00)	(3,607,876.00)
Provizioni i llogarive për biznese	(378,696.00)	(378,696.00)
Provizioni i llogarive për institucione	(447,985.00)	(447,985.00)
Lejime të bartura për shërbimet	(7,538.00)	(7,538.00)
	(144,478.00)	(144,478.00)
Total provizionimi	(4,608,379.00)	(4,586,573.00)
Përshkrimi	31.12.2024	31.12.2023
Provizioni i borxheve të këqija	18,222.13	24,474.00
Gjithsej	18,222.00	24,474.00

Shënim plotësues mbi provizionimin e borxheve:

Procesi i provizionimit të borxheve ka përfunduar për këtë fazë, dhe shuma e provizionuar është përcaktuar në vlerën prej 18,222.12 euro. Kjo përfshin edhe një pjesë të konsumatorëve për të cilët mungojnë adresat dhe konsiderohen si potencial për mos arkëtim. Shuma e provizionuar është miratuar nga Bordi i Drejtorëve.

Shënim nr. 3 - Stoqet

Ndërmarrja përdor metodën e vlerësimit të stokeve sipas sistemit të vazhdueshëm. Regjistrimi i vazhdueshëm i sasive të mallit bëhet në momentin e pranimit të mallit me metoda, me anë të të cilave përcaktohet kosto e stokeve sipas vlerës mesatare.

Tabela 6. Stoqet

Përshkrimi	23.12.2024 Vlera në €	31.12.2023 Vlera në €
Depo Kamenicë	56,280.81	51,325.05
Depo penda	36,771.59	37,371.59
Depo donacion	-	-
Depo baja kimikale	520.01	594.55
Depo e mbyllur Gjilan	209,289.80	195,567.16
Depo e hapur Gjilan	40,832.59	18,872.55
Depo materiale jo funksionale	546.73	13.51
Depo Përlepnicë Gjilan	43,393.73	43,117.46
Depo Viti	61,418.83	50,582.32
Material depo Velekincë/Gjilan	4,930.70	2,665.76
Material revers	1,910.54	2,470.38
Depo Punëtorja e Ujëmatësve	6,763.67	6,763.67
Gjithsej	462,659.00	409,344.00

Vlera e stoqeve paraqet më të ultën e kostos apo vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi shitës në rrjedha të zakonshme të biznesit, zvogëluar për koston e kompletimit, marketingut dhe shpërndarjes. Kostoja parimisht është përcaktuar në baza të çmimit mesatar.

Shënim nr. 4 – Pasuritë tjera afatshkurtra

Tabela 7. Pasuritë tjera afatshkurtra

Përshkrimi	31.12.2024 Vlera në €	31.12.2023 Vlera në €
Parapagimet të marra	58,349.00	63,077.00
Paradhënie ndaj punëtorëve	4,494.00	4,494.00
Parapagim i TVSH-së	16,735.00	1,251.00
Parapagim i tatimit në fitim	31,297.00	34,756.00
Gjithsej	110,875.00	103,578.00

Shënim nr. 5 - Prona, pajisjet dhe impiantet

Tabela 8. Prona, pajisjet dhe impiantet

Përshkrimi	31.12.2024	31.12.2023
Toka	5,270,695.00	1,902,000.00
Ndërtesa	15,685,686.00	4,863,572.15
Rrjeti i ujësjellësit, për instalime teknike, makineri, pajisje	28,240,467.00	5,700,910.26
Mjete transporti	560,440.00	378,036.89
Mobilje dhe pajisje zyre	482,633.00	2,273,368.00
Pajisje informative	86,520.00	41,402.87
Rrjeti i ujësjellësit	526,008.00	1,900,085.94
Rrjeti i kanalizimit	5,716,844.00	35,482.00
Investime, zgjerim i kapaciteteve të punës		37,310.17
Gjithsej	56,569,293.00	17,132,168.29

Tabela 9. Zhvlerësimi gjatë vitit 2024

Përshkrimi	Zhvlerësimi i akumuluar	Zhvlerësimi vitit 2024	Vlera totale
Ndërtesa	2,999,557.67	244,270.33	3,243,828.00
Rrjeti i ujësjellësit, instalime teknike, makineri, pajisje	04,344,510.52	236,943.48	4,581,454.00
Mjete transporti	0217,417.19	43,323.81	260,543.00
Mobilje dhe pajisje zyre	1,0931,096.00	112,136.00	2,043,232.00
Pajisje informative	029,568.76	7,373.24	36,942.00
Rrjeti i ujësjellësit	2071,162.42	104,772.58	375,935.00
Rrjeti i kanalizimit	01,033.09	1,865.91	2,899.00
Investime, zgjerim i kapaciteteve të punës	02,023.00	1,769.00	3,792.00
Gjithsej	9,8002,005.00	752,874.35	10,554,460.00

Shënim nr. 6 - Investimet në vijim/projektet

Kontrata	"Ndërtimi i kanalizimit në shtratin e lumit në Dobërqan - Gjilan";
Kontrata	"Ndërtimi i gypave të ujësjellësit për Gjilan, Viti dhe Kamenicë";
Kontrata	"Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit përgjatë rrugës nga tuneli deri në përfundim të rrugës magjistrale në fshatin Pasjak, Komuna e Gjilanit";
Kontrata	"Kycjet individuale për fshatrat Hodonoc, Dajkoc në Komunën e Kamenicës;
Kontrata	"Ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit në fshatin Karaçevë e Epërme në Komunën e Kamenicës";

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2024

